



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:092231

Datë: 09.08.2022

Numri i dokumentit: 03309475

**P.nr.105/14**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari Bekim Veliqi, antarët e trupit gjykues Gjyqtarja Florije Sylja dhe Gjyqtari Izet Gërguri me procesmbajtës Endrit Hajrizaj-Zyrtar Ligjor, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N.A nga ..., për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par.1 e lidhur me neni 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.116/2013, e datës 04.09.2014, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Natasha Radoviq, kanë prezentuar i akuzuari N.A dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Kadri Osaj nga Mitrovica, në bazë të nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së, pas mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim me datë 28.07.2022 është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.09.08.2022;

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: N.A**, nga i ati L., e ëma Sh., e gjinisë A., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna e ..., tani me vendbanim në rrugën "...", në Mitrovicë, me nr.personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar edhe më parë, ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:**

Me datën 27.05.2013, rreth orës 22:20 min., në rrugën "Arni Dinana", në Mitrovicë-Veri së bashku me N.N personin, me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të të dëmtuarës S.S, me qëllim që vetës t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyrë që, gjersa e dëmtuara ka qenë në shitoren e saj duke punuar, i pandehuri ka qenë me NN personin me automjet Golf ngjyrë e zezë dhe ka dalë nga automjeti dhe e ka thirrur të dëmtuarën që të dalë, pastaj e ka pyetur se a mbani cigare, ku e dëmtuara i është përgjigjur "Jo", atëherë i pandehuri me forcë të dëmtuarës ia ka marrë nga fyti zingjirin e arit dhe menjëherë ka shkuar tek automjeti Golf, ngjyrë e zezë dhe së bashku me NN personin ka ikur nga vendi i ngjarjes.

**Me këtë ka kryer veprën penale Grabitja, nga neni 329 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 45, 46, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së të akuzuarit i:

## SHQIPTON

**I. DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 23.06.2013 deri më datë 20.09.2013, si dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind (500) Euro të cilin dënim obligohet të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës së dënimit me gjobë, i njëjti dënim do të zëvendësohet në dënim me burgim, në kuptim të nenin 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzet (20)€ euro gjobë.

**II.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil juridik.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m i

### I. Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda ka parashtruar Aktakuzën PP.I.nr.116/2013 e datës 04.09.2014, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ndaj të akuzuarit N.A nga ..., për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par.3 e lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale Grabitje nga neni 329 par.3 e lidhur me par.1 e lidhur me neni 31 të KPRK-së në bashkim real me pikën I të dispozitivit dhe veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose angaloge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

### II. Rrjedha e procedurës

Gjykata Themelore Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me Aktakuzën PP.I.nr.116/2013 e datës 04.09.2014, ndaj të akuzuarit N.A për veprat penale të lartcekura, ka marrë Aktgjykimin P.nr.105/14 të dt.12.01.2022. Ndaj këtij Aktgjykimi kanë parashtruar ankesë Prokuroria Themelore Mitrovicë dhe mbrojtësi i të akuzuarit N.A, av.Kadri Osaj.

Gjykata e Apelit e Kosovës sipas Aktgjykimit PAKR.nr.71/22 të dt.23.06.2022, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit dhe në raport me pikën I të Aktgjykimit P.nr.105/14 të dt.12.01.2022, çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe vendosje, kurse e kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore Mitrovicë dhe ka vërtetuar Aktgjykimin P.nr.105/14 të dt.12.01.2022 në raport me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit. Në raport me pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit P.nr.105/14 të dt.12.01.2022, palët nuk kanë paraqitur ankesë.

Gjykata duke vepruar sipas udhëzimeve si në Aktgjykimin PAKR.nr.71/22 të dt.23.06.2022 të Gjykatës së Apelit, është caktuar dhe është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor me dt.27.07.2022, në të cilën seancë ka prezentuar Prokurori i Shtetit Natasha Radoviq, i akuzuari N.A dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Kadri Osaj. Në seancën e dt.27.07.2022 është ftuar në mënyrë të rregullt edhe e dëmtuara S.S mirëpo nga fletëkthesa e Gjykatës është konstatuar se sipas informacioneve e njëjta nuk gjindet në Kosovë dhe është duke jetuar tek

vajza e saj në Sërbi dhe nuk ka informacione se kur e njëjta do të kthehet në Mitrovicë. Procedura më tutje ka vazhduar me marrjen e veprimeve ligjore.

Shpallja publike e aktgjykimit është bërë me datë 28.07.2022, në seancë të hapur dhe publike, në mungesë të Prokurorit të Shtetit, akuzuarit dhe mbrojtësit av.Kadri Osaj.

### **III. Procedimi i dëshmitarëve**

Sipas Aktakuzë kanë qenë e propozuar që të dëgjohej në cilësinë e dëshmitares e dëmtuara S.S, mirëpo Gjykata nuk ka mundur që të sigurojë prezencën e saj në seancën e dt.27.07.2022 me konstatimin si në procesverbalin e seancës.

Prokurori i Shtetit ka propozuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të dt.27.07.2022 që të lexohet Procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor dt.20.12.2021 mbi marrjen në pyetje të dëmtuarës – dëshmitares S.S. Mbrojtësi dhe i pandehuri kanë deklaruar se nuk e kundërshtojnë propozimin e Prokurorit të Shtetit dhe se nuk kanë pyetje shtesë për shkak se janë sqaruar nga seancat e kaluara.

Trupi gjykues në bazë të nenit 338 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, ka marrë Aktvendim siç konstatohet në procesverbalin e seancës së dt.27.07.2022, dhe ka lexuar Procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor të dt.20.12.2021 mbi marrjen në pyetje të dëmtuarës – dëshmitares S.S.

***Në seancën e dt.20.12.2021, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar e dëmtuara S.S e cila ka deklaruar se*** e kam mbajtur një dyqan në rrugën Andri Dinan ku aty mbaj pajise për varrim, në atë dyqan edhe kam fjetur, në pjesën e përparme kam pasur pajisje për varrim e në pjesën tjetër kam të rregulluar edhe çështjen e banimit dhe atë ditë aty kam fjetur dhe vetëm për vikende shkoj në shtëpi, atë mbrëmje me datë 27.05.2013 gypin për ujë kam dashur ta vendos brenda dhe kur kam dalur në kthesë nga qyteti ka ardhur një veturë pa tabela ku kanë qenë dy persona, vozitësi dhe pasagjeri, kanë vozitur ngadalë, kanë shikuar majtas dhe djathtas dhe kanë shkuar në drejtim të hyrjes së spitalit por e kanë drejtuar shumë ngadalë automjetin, kur e kam mbledhur gypin për ujë dhe kam menduar se këta kanë ardhur që të blejnë pajisje për varrim, nuk kanë hyrë në oborrin e Spitalit dhe janë kthyer aty menjëherë, i kam shikuar se si ata kanë lëvizur dhe e kanë parkuar automjetin menjëherë tek një dru që është si pemë, derisa e kam vendosur unë gypin e ujit në banjo, e ceku se një kolegut tim ia kanë vjedhur një kombi, dhe njërin nga ata dy personat që ishin në automjet e kam vërejtur se janë fshehur pas një shtylle elektrike dhe kam menduar se ata po përgatiten që të vjedhin prapë kolegun tim, megjithatë, duke e shikuar televizorin unë kam qenë brenda dhe është afruar ky zotriu (i referohet të pandehurit N.A, por në atë moment nuk e kam njohur) dhe më ka ftuar me dorë që të dal jashtë, kam dalur dhe ai më ka pyetur a mbani cigare, nuk kam arritur as të përgjigjem me atë shpejtësi me dorë ma ka këputur zingjirin nga fyti, ka qenë një zingjir i arit me figurë, dhe e ka marrur, në atë moment si e humbur kam vrapuar pas tij dhe ata e kanë vozitur veturën, pastaj e kam mbyllur shitoren dhe kam shkuar në polici, dhe e kam lajmëruar rastin, ditën e nesërme kanë ardhur dy polic në rroba civile me fotografi dhe mi kanë treguar fotografitë e disa personave dhe në foton e tretë e kam njohur personin që më ka vjedhur, kur na ka ftuar policia për identifikimin e foteve, kemi qenë përafërsisht 15 persona palë të dëmtuara, kemi qenë në një sallë të madhe dhe këtu kanë qenë krejt në xham dhe i kemi pasur dy vrima për të shikuar, kanë qenë rreth 10 persona sa më kujtohen, kanë pasur numra, ka qenë edhe avokati i tij i cili më ka pyetur çfarë ka pasur veshur, jam përgjigjur se nuk e kam shikuar çka ka pasur veshur por e kam shikuar vetëm fytyrën, kur ka ardhur dhe ma ka marrë zingjirin nuk ka pasur as maskë dhe as kapele në kokë, kur kam qenë në identifikim e kam njohur, ka qenë i treti me

radhë dhe kam qenë e sigurtë 100% se ai ka qenë, kanë kaluar disa vite, atëherë nuk ka pasur mjekërr dhe mustaqe, kurse tani ka, atëherë kam qenë e sigurtë tek identifikimi, ky është, vetëm tani që ka mjekërr dhe mustaqe (referohet tek i pandehuri N.A gjatë seancës), fotografit policia më kanë treguar një nga një, automjeti ka qenë Golf, ngjyrë e zezë pa tabela, policia më kanë pyetur fillimisht se si duken, i kam thënë që ka qenë zeshkan, nuk ka pasur flokë në pjesën e përparme, prapa ka pasur flokë, ka qenë ngjarje si në film, ka ndodhur në sekonda, më ka pyetur për cigare dhe nuk kam pasur kohë as të përgjigjem dhe më ka tërhequr zingjirin nga fyti.

#### **IV. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.**

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.27.07.2022 në cilësinë e provave janë administruar: *Raportet e policit Bojan Kostiq të dt.29.05.2013 dhe 23.06.2013, Raporti i policit Bojan Vukashinoviq i dt.13.06.2013, Procesverbali mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013, Fotodokumentacioni në shkresat e lëndës.*

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.27.07.2022 ka deklaruar se tërhiqem nga propozimi që të lexohen si prova *Raporti i policit Jovica Drobnjak i dt.22.05.2013; Raporti mjekësor në emër të të dëmtuarës Nada Gjokoviq; Lista e gjërave të konfiskuara – substancës narkotike nga i pandehuri dt.23.06.2013; Raporti i ekspertizës nga Njësia e Shkencave Ligjore analiza kimike të MPB nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë e dt.26.05.2014.*

Prokurori i Shtetit, mbrojtësi dhe i pandehuri nuk kanë pasur propozime të tjera për plotësimin e procedurës së provave siç konstatohet në procesverbalin e seancës gjyqësore të dt.27.07.2022.

#### **V. Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari**

I akuzuari N.A në seancën e dt.27.07.2022, është njoftuar me të drejtat e tij nga neni 232 dhe 346 të KPP-së, dhe i njëjti ka deklaruar se shfrytëzon mundësinë e mbrojtjes në heshtje. Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se mundësia e mbrojtjes në heshtje – mos deklarimit është mundësi ligjore e paraparë me nenin 346 par.1 të KPP-së.

#### **VI. Fjala përfundimtare**

**VI/1. Prokurori i Shtetit në seancën e dt.27.07.2022 ka paraqitur fjalën përfundimtare në të cilën ka deklaruar** se në parim mbetem pranë fjalës përfundimtare të paraqitur nga seanca e kaluar por tani në këtë fazë kemi të bëjmë vetëm për një vepër penale si në pikën 1 të dispozitivit të Aktakuzës, dhe kjo aktakuzë mbështetet në provat konkrete si ato personale dhe materiale duke u bazuar në dëshminë e dëshmitares së të dëmtuarës dhe nga identifikimi i bërë po ashtu edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i propozoj Gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

**VI/2. Mbrojtësi i të akuzuarit N.A, av.Kadri Osaj në seancën e dt.27.07.2022, ka paraqitur fjalën përfundimtare në të cilën ka deklaruar** se qëndroj pranë theksimeve lidhur me veprën penale që tani është në rishqyrtim, konsideroj që Prokuroria me asnjë provë nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i mbrojturi im ka kryer veprën penale, procesi i identifikimit është i manipuluar dhe në momentin kur ne kemi shkuar na kanë thënë se për herë të parë po e bëjnë identifikimin, pasi që është bërë një identifikim paraparë jo ligjor për të cilën kemi rënë në dijeni nga e dëmtuara, pasi që e njëjta thotë që në zyrën e saj i kanë sjellë 3 fotografi në zyrën e saj dhe është bërë identifikimi, unë nuk kam qenë prezent në këtë identifikim dhe nuk ka pasur mbrojtës të tjerë, unë mendoj identifikimi i bërë në prezencën e avokatit duke marrë

për bazë identifikimin paraprakë ka qenë një përpjekje për të legjitimuar identifikimin kundërligjor dhe në këtë mënyrë përpos që ka pas shkelje procedurale me pasoja disiplinore e kanë shkelur edhe ligjin, për të vërtetuar këtë fakt e ceku edhe deklaratën e të dëmtuarës e cila një ditë pas rastit ka thënë se ka qenë ulur dhe e ka identifikuar personin duke i thënë a je ti ai që më ke grabitur, po ashtu rrethanë tjetër është se ditën kritike është se e njëjta ka theksuar se kanë qenë dy persona që kanë ardhur me makinë ashtu që i mbrojturi im nuk ka fare makinë dhe nuk vozitë makinë, në procedurë hetimore nuk është hetuar çështja penale në mënyrën e drejtë ashtu që ka dështuar zbulimi i rastit dhe padrejtësisht i mbrojturi im është involvuar në këtë rast, ashtu që Gjykatës i propozoj që Aktakuzën ta refuzoj si të pabazuar dhe i mbrojturi im të shpallet i pafajshëm.

**VI/3. I pandehuri në seancën e dt.20.12.2021, ka paraqitur fjalën përfundimtare në të cilën ka deklaruar** se e mbështes deklarinimin e mbrojtësit tim dhe qëndroj pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit, unë nuk e kam bërë këtë veprim kërkoj që të lirohem nga kjo akuzë..

**VII. Gjetjet e Gjykatës në raport me çështjet ligjore dhe rrethanat faktike dhe vlerësimin e provave.**

Pas procedimit të provave materiale dhe atyre personale në këtë çështje të konstatuara si më lart dhe vlerësimin të tyre një nga një, deklarinimit të dëshmitares - të dëmtuarës S.S gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, paraqitjes së fjalës përfundimtare nga palët dhe mbrojtësit dhe pas vlerësimin të tyre në ndërlidhshmërinë me provat, Gjykata gjeti se i akuzuari N.A është fajtor për veprën penale Grabitje nga neni 329 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me arsyet ligjore dhe faktike që do të konstatohen veç e veç për secilën veprë penale në vijim të këtij Aktgjykimi te konstatuara si me poshtë;

**VII/1. Gjetjet e Gjykatës në raport me veprën penale nga pika I e dispozitivit të Aktakuzës.**

Për të konstatuar se është kryer një veprë penale duhet që të përmbushen elementet e veprës penale, të ekzistoj dashja direkte apo eventuale e kryesit si dhe të vërtetohet në pajtueshmëri me provat materiale, dëshmitë e dëshmitarëve që në veprimet e të akuzuarit krijohen elementet e veprës penal për të cilën akuzohet.

Në rastin konkret i akuzuarit si në dispozitivin të Aktgjykimit është shpallur fajtor për veprën penale Grabitje nga neni 329 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Vepra penale e Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së, kryhet në atë mënyrë që kushdo me anë të përdorimit të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, e në rastin konkret Gjykata vërtetoi përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuarit me veprimet e tij ka përmbushur elementet e veprës penale si në dispozitivin të Aktgjykimit.

Fillimisht Gjykata, ka vlerësuar Deklaratën e dëshmitares-të dëmtuarës S.S të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.20.12.2021, e cila ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë brenda duke e shikuar televizorin kur është afruar **“ky zotëriu” (e që në seancë i është referuar të akuzuarit N.A)**, duke e ftuar me dorë që të dalë jashtë, dhe i njëjti e ka pyetur se a mbani cigare, kurse e dëmtuara i është përgjigjur se jo nuk mbajnë, atëherë i akuzuari me shpejtësi me dorë i'a ka këputur zingjirin nga fyti me përdorim të forcës, i cili ka qenë zingjir i arit, ku i akuzuari ka vrapuar dhe është larguar me automjet pasi që nga e dëmtuara ka marrë zingjirin, ku e dëmtuara-dëshmitarja në seancën e shqyrtimit gjyqësor në raport me identifikimin e të akuzuarit në sallë ka deklaruar po ashtu se **nga rasti kanë kaluar disa vite, atëherë i pandehuri nuk ka pasur mjekërr dhe mustaqe, kurse tani ka, atëherë kam qenë e sigurtë tek**

***identifikimi, por edhe tani ky është, vetëm tani që ka mjekërr dhe mustaqe (në seancë i është referuar tek i akuzuari N.A).***

Gjykata në raport me dëshminë e dëshmitares - të dëmtuarës S.S i fal besimin e plotë në raport me çështjen për të cilën është vërtetuar gjendja faktike në këtë Aktgjykim si në dispozitiv për faktin se e dëmtuara – dëshmitarja S.S po ashtu ka dhënë një deklaratë në Polici me dt.27.05.2013, në raport me çështjen, ku e njëjta ka deklaruar se ditën kritike një person e ka thirrur që të dal përpara dyqanit dhe e ka pyetur a mbajnë cigare, kur i është përgjigjur se jo ai me shpejtësi të madhe dhe force i ka këputur zingjirin nga fyti dhe ka vrapuar dhe është larguar drejtë automjetit ku janë larguar me shpejtësi të madhe dhe e njëjta e ka përshkruar personin se si është dukur.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e dëmtuara – dëshmitarja S.S, në dy dëshmitë e saja të dhënë në Polici dhe në Gjykata, nuk ka pasur kundërtënie në mes të dëshmimeve të saj, e si të tilla Gjykata ka vlerësuar, krahasuar dhe analizuar secilën dëshmi veç e veç duke i falur besimin e plotë në drejtim të vërtetimit përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të Aktgjykimit, e po ashtu Gjykata gjen se dëshmia e dëshmitares është po ashtu në përputhje të plotë edhe me provat tjera të cilat janë administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata në vlerësim të dëshmisë së dëshmitares – të dëmtuarës S.S, në lidhshmëri me provat e tjera materiale, gjen se dëshmia e dëshmitares në këtë rast po ashtu mbështetet dhe është në përputhje të plotë pa asnjë kundërtënie edhe me *Procesverbalin mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*, i cili si provë është administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.20.12.2021, ku në këtë Procesverbal është konstatuar se e dëmtuara – dëshmitarja S.S në prezencën e mbrojtësit të të akuzuarit av.Kadri Osaj, ka bërë identifikimin e të akuzuarit N.A, **me numër 5 pas ndërrimit të numrave në bazë të kërkesës së mbrojtësit av.Kadri Osaj, edhe pas këtij ndryshimi e dëmtuara – dëshmitarja S.S e ka bërë identifikimin e të akuzuarit N.A duke e identifikuar se personi me numër 5 siç konstatohet në fq.2 të *Procesverbalit mbi identifikimin e personave i dt.24.06.2013*, si personi i cili është kryesi i veprës penale me përshkrimin si në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit.**

Gjykata gjenë se *Procesverbali mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*, është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi konkretisht nenit 120 të KPP-së, po ashtu në prezencën e mbrojtësit të akuzuarit N.A, av.Kadri Osaj dhe si të tillë Gjykata e ka vlerësuar si provë bindëse dhe i ka falur besimin në raport të vërtetimit përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke bërë vlerësimin, krahasimin dhe analizimin e dëshmimeve të dëshmitares S.S, në lidhshmëri me provat e tjera konkretisht *Procesverbalit mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*, dhe duke j'u falur besimin e plotë dëshmisë së dëshmitares bazuar në faktet si më lart gjen se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur elementet e veprës penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së, si në dispozitiv të Aktgjykimit, ku përcaktohet se kushdo me anë të përdorimit të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, e që tek kjo veprë penale nuk është e domosdoshme që veprimet e kryerjes të ndërmerren në mënyrë komulative nga ana e kryesit mirëpo mjafton që të ndermirët ndonjëri nga veprimet e që në rastin konkret Gjykata ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari me ndërmarrjen e veprimeve konkretisht me përdorimin e forcës e ka përvetësuar pasurin e të dëmtuarës S.S

(zingjirin e arit) në mënyrë që veti t'i sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, e që në rastin konkret janë përmbushur elementet e veprës penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së me përshkrimin si në dispozitiv të Aktgjykimit, në rastin konkret tek vepra penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së, duhet të ekzistoj dashja direkte e kryesit për kryerjen e veprës penale e që i akuzuari me veprimet e tij inkriminues për të cilat është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti i ka ndërmarrë këto veprime me arsyet e cekura si më lart, Gjykata gjeti se edhe elementi i dashjes direkte të akuzuarit N.A për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të Aktgjykimit në këtë rast është përmbushur bazuar në faktet e cekura si më lart në këtë Aktgjykim.

Gjykata në rastin konkret po ashtu ka marrë parasysh të gjitha vërejtje si në Aktgjykimin PAKR.nr.71/22 të dt.23.06.2022 të Gjykatës së Apelit dhe vendosi si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj ka dhënë shembuj duke j'u referuar edhe vendimeve të Gjykatës Supreme të SHBA-së, ku ka theksuar se dëshmia e identifikimit të dëshmitarëve okularë paraqesin rreziqe reale të dënimit të gabuar për shkak të identifikimi të gabuar dhe vërejtje të tjera siç konstatohen në Aktgjykimin PAKR.nr.71/22 të dt.23.06.2022.

Gjykata në rastin konkret nuk vlerëson se vet pozita e të akuzuarit në sallën e gjykimit dhe dijenia se ndaj tij është duke u udhëhequr procedura penale kanë bërë që dëshmitarja – e dëmtuara S.S të jap dëshmi sugjestionuese dhe të prirur për identifikim pozitiv të akuzuarit duke u bazuar në disa faktet si më poshtë:

**I.** Fillimisht Gjykata siç edhe e ka sqaruar edhe më lart në këtë Aktgjykim, dëshmitarja S.S ka bërë identifikimin e të akuzuarit qysh në vitin 2013 ashtu siç edhe konstatohet në *Procesverbalin mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*, pra në këtë rast nuk është që dëshmitarja – e dëmtuara e sheh për herë të parë të akuzuarin dhe për herë të parë bënë identifikimin e tij vizual vetëm pasi që e sheh të njëjtin në sallën e gjykimit duke u zhvilluar procedura penale ndaj tij, sikur dëshmitarja – e dëmtuara në këtë rast për herë të parë do të ballafaqohej me të akuzuarin në sallën e gjykimit atëherë do të kishte hapësirë për të vlerësuar se dëshmitarja – e dëmtuara bënë një identifikim – dëshmi sugjestive, andaj mbi këtë bazë Gjykata ashtu edhe siç ka theksuar më lart në këtë Aktgjykim, dëshmisë së dëshmitares – të dëmtuarës S.S i ka falur besimin e plotë lidhur me atë se çka ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi që e njëjta dëshmi mbështetet edhe në provat e tjera siç është *Procesverbali mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*.

**II.** Sa i përket kundërthënieve lidhur me deklarin e të dëmtuarës se e njëjta ka deklaruar se “të nesërmen në mëngjes kam qenë para shitores me kolegun tim, një djalë i ri ka qëndruar dhe më ka thënë a pihet ky uji nga ky gyp dhe unë e kam pyetur a je ti personi që më ke këput zingjirin” ... “ka qenë ngjarje si në filma, ka ndodhur në sekonda, më ka pyetur për cigare dhe nuk kam pasur kohë as të përgjigjem dhe më ka tërhequr zingjirin nga fyti”, Gjykata nuk gjen kundërthënie mes këtyre deklarimeve të dëshmitares – të dëmtuarës bazuar në dy fakte:

1. Në deklarin e parë e dëshmitarja – e dëmtuara ka bërë një përshkrim të një ngjarje që ka ndodhur ditën e nesërme pasi që ka ndodhur rasti konkret, ku ka përshkruar se çka ka komunikuar me atë person, mirëpo këto dyshime dëshmitarja për asnjë moment të vetëm nuk i ka pasur kur e ka bërë identifikimin e të akuzuarit si në *Procesverbalin mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*, e për më tepër këto dyshime nuk i ka pasur as gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ku e njëjta edhe në seancë e ka bërë

identifikimin e të akuzuarit ku ka deklaruar se *“nga rasti kanë kaluar disa vite, atëherë i pandehuri nuk ka pasur mjekërr dhe mustaqe, kurse tani ka, atëherë kam qenë e sigurtë tek identifikimi, por edhe tani ky është, vetëm tani që ka mjekërr dhe mustaqe (në seancë i është referuar tek i akuzuari N.A)”* madje ka arritur që të bëjë dallimin tek detajet e të akuzuarit siç është mjekra dhe mustaqet.

2. Sa i përketë deklaramit të dytë ku e dëmtuara bënë përshkrimin e ngjarjes se si ka ndodhur, Gjykata nuk mundi të gjejë asnjë “dyshim” të vetëm tek ky deklaram i dëshmitarës – të dëmtuarës, pasi që ajo vetëm ka bërë përshkrimin e rastit se si ka ndodhur, pra Gjykata rithekson se tek ky deklaram i të dëmtuarës – dëshmitarës kemi vetëm përshkrimin e ngjarjes se si ka ndodhur dhe brenda përmbajtjes së këtij deklarami nuk kemi kundërthënje, sipas vlerësimit të Gjykatës nuk mund të arrihet ndonjë përfundim ndryshe lidhur me këto deklaramime të dëshmitarës – të dëmtuarës.

**III.** Gjykata e Apelit në Aktgjykimin PAKR.nr.71/22 të dt.23.06.2022, ka theksuar tri fakte relevante që e karakterizojnë çështjen konkrete dhe atë: 1) identifikimi i të akuzuarit nga e dëmtuara, për ngjarjen që ka ndodhur në sekonda; 2) pa e njohur personin, të cilin nuk e ka parë asnjëherë; 3) si provë e vetme, pa mbështetje në ndonjë provë apo dëshmi tjetër.

Gjykata sa i përketë faktit të parë “identifikimi i të akuzuarit nga e dëmtuara, për ngjarjen që ka ndodhur në sekonda”, vlerëson se në rastin konkret dëshmitarja ka arritur që të bëjë identifikimin e të akuzuarit **jo vetëm në një rast mirëpo në dy raste** dhe atë gjatë identifikimit të akuzuarit si në *Procesverbalin mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013* po ashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor. Fakti se “ngjarja ka ndodhur brenda sekondave” nuk do të thotë që tani Gjykata të lëshohet në supozime dhe të cenoj deklaramet e dëshmitarës e që për më tepër e njëjta është edhe palë e dëmtuar në këtë rast dhe të dalin supozime të pabaza se dëshmitarja – e dëmtuara brenda “këtyre sekondave” nuk ka arritur që të bëjë identifikimin e të akuzuarit.

Sa i përketë çështjes se “pa e njohur personin, të cilin nuk e ka parë asnjëherë”, Gjykata prapë fillon nga fakti se nëse lëshohemi në një vlerësim të tillë të rastit atëherë do të dalin supozime të pabaza, duke pasur parasysh se në një rast fare nuk është relevante nëse dëshmitari e ka parë apo jo më parë të akuzuarin, e që për më tepër edhe në rastin konkret fare nuk është fakt relevant se dëshmitarja – e dëmtuara a e ka parë apo jo të akuzuarin më parë. Sikurse Gjykatat në raste të ndryshme do të nisëshin nga supozimet e tilla se dëshmitari nuk e ka parë të akuzuarin më herët atëherë do të krijohej një pasiguri e tillë juridike që deklaramet e dëshmitarëve nuk do të vlenin në asnjë rast për identifikimin e të akuzuarve pasi që dëshmitarët nuk e kanë parë më herët të akuzuarin. Pra edhe në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës nuk mund të themi se nuk qëndron deklarami i dëshmitarës – të dëmtuarës kur ka bërë identifikimin e të akuzuarit pasi që e njëjta nuk e ka parë të akuzuarin më parë.

Sa i përketë çështjes se “si provë e vetme, pa mbështetje në ndonjë provë apo dëshmi tjetër”, Gjykata nuk e vlerëson se në rastin konkret është prova e vetme deklaramet e dëshmitarës – të dëmtuarës S.S, pasi që në rastin konkret ashtu edhe siç ka theksuar Gjykata më lart në këtë Aktgjykim dëshmitarja përveç që e ka bërë identifikimin e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.20.12.2021, e njëjta e ka bërë identifikimin e të akuzuarit edhe në *Procesverbalin mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013*, pra në rastin konkret dëshmitarja – e dëmtuara ka bërë identifikimin e të akuzuarit fillimisht me dt.24.06.2013 e pastaj edhe me dt.20.12.2021, pra kanë kaluar më shumë se 8 vite dhe dëshmitarja prapë ka qenë në gjendje që të bëjë identifikimin e të akuzuarit, madje edhe sa i përketë detajeve siç e



thekson Gjykata më lart në këtë Aktgjykim. Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi vetëm një provë të vetme mbi të cilin është bazuar Aktgjykimi pasi që kemi deklaratën e dëshmitarës – të dëmtuarës të dhënë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor me dt.20.12.2021 dhe Procesverbalin mbi identifikimin e të pandehurit i dt.24.06.2013, po ashtu provat e tjera të cekura në pikën IV të këtij Aktgjykimi e për më tepër Gjykata thekson se sipas nenit 262 par.1 të KPP-së përcaktohet se *“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”* e që në rastin konkret mbrojtësi dhe i akuzuari kanë pasur mundësinë që të kundërshtojnë të gjitha provat në të cilat është mbështetur ky aktgjykim gjatë gjitha fazave të procedurës penale mirëpo vlerësimi i lirë i Gjykatës ka qenë që t’i falë besimin e plotë pa ndonjë mëdyshje të gjitha provave të propozuara nga Prokuroria dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj Gjykata nuk gjen ndonjë bazë ligjore lidhur me faktin se Aktgjykimi bazohet vetëm në një provë të vetme pasi që në rastin konkret edhe sikur të qëndronte ky fakte prova do të ishte e atillë e cila nuk mund të kundërshtohet nga i akuzuari ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

Gjykata po ashtu thekson se në rastin konkret provat në të cilat është mbështetur ky Aktgjykim janë prova bindëse dhe nuk ekziston rreziku që në këto prova ka mëdyshje – dyshime sa i përketë kualitetit të provës dhe fakteve që vërtetojnë, pasi që këto prova janë marrë në mënyrën e përcaktuar ligjore dhe besueshmëria dhe saktësia e tyre është shumë e lartë në raport me faktet të cilat vërtetojnë bazuar në sqarimet e Gjykatës si më lart në këtë Aktgjykim. Gjykata thekson se në rastin konkret në tërësi është respektuar procedura e provave dhe është respektuar e drejta e mbrojtjes që t’i kundërshtojnë këto prova, ku në rastin konkret mbrojtja nuk i ka ofruar Gjykatës ndonjë provë tjetër e cila do të bindte Gjykatën për të vendosur ndryshe nga ky Aktgjykim.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 370 par.7 të KPP-së, pasi që ka dhënë sqarime për secilin fakt vendimtar lidhur me çështjen, ka vlerësuar secilën provë dhe fuqinë provuese të saj lidhur me faktet që ka vërtetuar po ashtu ka vlerësuar drejtë dhe saktë të gjitha dispozitat ligjore të KPRK-së dhe KPP-së, duke marrë vendim si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

### **VIII. Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit**

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata duke u mbështetur në nenin 73 të KPRK-së dhe rregullave të përgjithshme për matjen dhe zbutjen e dënimit të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit si rrethana posaçërisht lehtësuese mori se është prind i tre fëmijëve, mbajtës i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar mbi 8 vite, po ashtu Gjykata vlerësoj se koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga dt.08.10.2014 deri me dt.06.01.2015 ka ndikuar dhe ka pasur efekt në rehabilitimin e të akuzuarit që i njëjti në të ardhmen të mos bie ndesh me ligjin, rrethanë të cilën e ka theksuar edhe vet i akuzuari, rrezikshmëria e veprimeve të tilla për shoqërinë si rrethana renduese, por gjykata në vlerësim të rrethanave të theksuara si më lart i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar me bindjen të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së, duke pasur efektin në parandalimin e kryeseve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, andaj gjykata nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimi i

shqiptuar me arsyet e theksuara është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të akuzuarin.

**IX. Shpenzimet e procedurës**

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 453 të KPP-së ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ndërsa udhëzimi i palës së dëmtuar për realizimin kërkesës pasurore juridike në kontest civilo-juridik u mbështet në nenin 463 të KPP-së.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË  
Departamenti për Krime të Rënda  
P.nr.105/14 dt.09.08.2022**

**Procesmbajtësi  
Endrit Hajrizaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Bekim Veliqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.